



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTVENDIM

Nr. ____/2019

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME TË VENDIMIN NR 84/2019 “ PËR NGRITJEN
KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË
SË VEPRIMEVE TË KRYERA NGA ANA E PRESIDENTIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË KUADËR TË USHTRIMIT TË
KOMPETENCAVE TË TIJ LIDHUR ME ZHVILLIMIN E ZGJEDHJEVE
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE” I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 3, 5, pika 2, dhe 8, pikat 1, dhe 3, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të neneve 55 dhe 112, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, Rezolutës nr.137/2019 “Shmangia e krizës kushtetuese me synim legjitimitetin e Gjykatës Kushtetuese - detyrë imperative e organeve më të larta të Shtetit,”kërkesës së 55 deputetëve të grupit parlamentar të Partisë Socialiste “ Për shtimin e objektit të Komisionit Hetimor “si dhe kërkesës të Komisionit Hetimor “Për zgjatje të afatit të Komisionit Hetimor “

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në vendimin nr 84/2019” Për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.” bëhen shtesat dhe ndryshimet e më poshtme:

I. Titulli i Vendimit ndryshohet dhe bëhet si me poshtë:

“Për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore si dhe për të kontrolluar e ligjshmërinë e veprimeve dhe procedurës të ndjekur nga Presidenti i Republikës në kuadër të emërimit të gjyqtarëve kushtetues”

II. Në paragrafin III ‘ Objekti i punës së Komisionit Hetimor’ pas shkronjës” ç” shtohen shkronjat ‘d’ dhe “dh” me këtë përmbajtje:

“d. Kontrollin e ligjshmërisë të veprimeve dhe procedurës të ndjekur nga Presidenti i Republikës në kuadër të emërimit të gjyqtarëve kushtetues;

“dh. Shqyrtimi dhe vlerësimi i pasojave që vijnë nga veprimet dhe procedura e ndjekur nga Presidenti i Republikës në kuadër të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese ”

III. Paragrafi VI ndryshohet si më poshtë :

Afati i veprimtarisë së Komisionit Hetimor zgjatet 4 muaj nga data e mbarimit të afatit të parashikuar në vendimin nr. 112/2019 të Kuvendit.” Për zgjatjen e afati i veprimtarisë së Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 5.12.2019